REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 02.10.2026

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik Nr.001/2022, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 10.09.2026, të parashtruar nga Operatori Ekonomik "INFINITT SH.P.K"., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me material zyrtar, topa të edukatës fizike dhe mjete didaktike", Nr. i prokurimit- 632-26-7040-1-2-1, Nr. i brendshëm 632-26-052-121, nxjerr:

V E N D I M

1. **REFUZOHET SI E PABAZUAR** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "INFINITT SH.P.K"., e dt. 30.09.2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me material zyrtar, topa të edukatës fizike dhe mjete didaktike", Nr. i prokurimit- 632-26-7040-1-2-1, Nr. i brendshëm 632-26-052-121, njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues, të publikuar me datë 25.09.2026 të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. **VËRTETOHET** njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues, i publikuar me datë: 25.09.2026, përmes të cilit është vendosur anulimi i aktivitetit të prokurimit.

3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së.

A r s y e t i m

Operatori ekonomik "INFINITT SH.P.K"., me dt.30.09.2026, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me material zyrtar, topa të edukatës fizike dhe mjete didaktike", Nr. i prokurimit- 632-26-7040-1-2-1, Nr. i brendshëm 632-26-052-121.

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Gjakovës, më datë 02.10.2026, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe, pas analizimit dhe vlerësimit të pretendimeve të parashtruara, ka konstatuar se:

Autoriteti Kontraktues, gjatë përgatitjes dhe zhvillimit të aktivitetit të prokurimit, ka përcaktuar nevojat për furnizimet objekt të këtij aktiviteti dhe ka bërë planifikimin përkatës të vlerës së

parashikuar, në përputhje me nevojat e identifikuara dhe mjetet financiare të planifikuara për këtë qëllim.

Fakti se ofertat e dorëzuara kanë rezultuar me vlerë më të lartë se buxheti i planifikuar nuk nënkupton, në vetvete, se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së. Përkundrazi, gjatë shqyrtimit të ofertave AK është i detyruar të vlerësojë ofertat në raport me kërkesat dhe kushtet e përcaktuara në dokumentet e tenderit, përfshirë edhe aspektin financiar të aktivitetit të prokurimit.

Pretendimi i OE-së se çmimet e ofertës pasqyrojnë çmimet reale të tregut dhe se rritja e çmimeve të produkteve ka ndikuar në vlerën e ofertës, nuk e ndryshon faktin e konstatuar gjatë procesit të vlerësimit, përkatësisht se vlera e ofertës ka tejkaluar buxhetin e planifikuar për këtë aktivitet të prokurimit.

Po ashtu, argumenti i OE-së se tejkalimi i buxhetit është më pak se 5% nuk përbën, në vetvete, bazë ligjore për detyrimin e AK-së që të pranojë një ofertë e cila tejkalon buxhetin e planifikuar.

Sa i përket pretendimit se buxheti i përcaktuar nga AK ka qenë i ulët në raport me çmimet aktuale të tregut, AK vlerëson se ky është një pretendim i OE-së i cili nuk mund të merret si fakt i konstatuar vetëm mbi bazën e deklarimit të tij. Çmimet e ofertës përfaqësojnë çmimet e ofruara nga OE në kuadër të këtij aktiviteti, ndërsa përcaktimi i përshtatshmërisë së vlerës së parashikuar duhet të vlerësohet mbi bazën e dokumentacionit të aktivitetit të prokurimit dhe të të dhënave të disponueshme në momentin e planifikimit të tij.

Për këtë arsye, ky pretendim i OE-së refuzohet si i pabazuar.

Edhe, fakti se AK-ja i ka kërkuar OE-së dokumentacion shtesë gjatë procesit të vlerësimit nuk përbën vendim përfundimtar për dhënien e kontratës dhe nuk e kufizon AK-në që, pas përfundimit të plotë të vlerësimit, të marrë vendim në përputhje me gjetjet e këtij procesi. Kjo kërkesë është bërë në kuadër të procesit të verifikimit dhe përfundimit të vlerësimit, ndërsa vendimi përfundimtar është marrë pas përfundimit të këtij procesi dhe në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit dhe legjislacionit në fuqi.

Në rastin konkret, pas përfundimit të procesit të vlerësimit, AK-ja ka konstatuar se vlera e ofertës së OE-së është mbi vlerën e parashikuar të kontratës. Për këtë arsye, oferta është refuzuar/anuluar në bazë të arsyetimit të dhënë në vendimin përkatës.

Lidhur me pretendimin e OE-së se AK-ja/Njësia kërkuese duhet të hulumtojë edhe njëherë tregun dhe të kalkulojë koston e blerjes së produkteve, me qëllim të dëshmimit se buxheti i planifikuar nuk ka qenë i mjaftueshëm, AK-ja sqaron se ky pretendim nuk mund të shërbejë si bazë për ndryshimin e vlerësimit të bërë në kuadër të këtij aktiviteti të prokurimit.

Fakti që OE-ja pretendon se çmimet e ofruara prej tij janë në përputhje me çmimet dhe marzhat reale të tregut nuk mund të përcaktojë, në vetvete, shumën që AK-ja mund ose duhet të paguajë për furnizimet objekt të këtij aktiviteti të prokurimit. Marzha e aplikuar nga një operator ekonomik, struktura e kostove të tij dhe çmimi me të cilin ai ka zgjedhur të ofertojë përbëjnë elemente të ofertës së tij dhe nuk mund të shërbejnë, në vetvete, si bazë për ndryshimin apo rritjen e vlerës së parashikuar të kontratës dhe të buxhetit të përcaktuar nga AK-ja.

Gjithashtu, në pajtim me dipozitat ligjore të legjislacionit në fuqi, Autoriteti Kontraktues mund ta përfundojë aktivitetin e prokurimit kur të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime

që tejkalojnë buxhetin e Autoritetit Kontraktues për aktivitetin përkatës të prokurimit. Në rastin konkret, oferta e OE-së, e cila pretendohet se është oferta e përgjegjshme me çmimin më të ulët, ka tejkaluar buxhetin e përcaktuar për këtë aktivitet të prokurimit.

Në këtë rast, AK-ja ka vlerësuar rrethanat konkrete të aktivitetit të prokurimit dhe, në mungesë të bazës për vazhdimin e procedurës brenda buxhetit të përcaktuar, ka marrë vendimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

Kopje:
Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Të gjitha palëve te interesuara;

FATON GUTAJ

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

Këshilla juridike:
Kundër këtij vendimi, pala e paknaqur brenda afatit prej 10 ditëve mund të paraqesë ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP).